

# "ISHA BULLIZUES"

## i Andrea Franzosos

### SKEDA 4

#### KAPITULLI 10-11-12

### "Hetimet"

Në grabitjen e Unikreditit, Maksimi bën një gabim të rëndë: cilin?

- E detyron pastruesen t'i mbajë duart lart pa e kuptuar se është para kamerave.
- Humbet kartën e identitetit.
- Harroi briskun, i cili kishte gjurmët e gishtërinjve të tij.

Pse Maksimi identifikohet i pari?

- Sepse policia i kishte marrë gjurmët e gishtërinjve kur ai e rinovoi lejen e qëndrimit.
- Sepse Danieli duket më i zakonshëm.
- Për shenjën nën syrin e djathtë.

Çfarë janë dëshmitarët okularë?

.....

.....

.....

.....

#### Fjalët janë të rëndësishme

**1.** Në gjuhën e përditshme përdorim shumë fjalë angleze që nuk i perceptojmë më si të huaja. Duke raportuar lajmin e përhapur në internet, autori shkruan: "...një escalation[MR1] grabitjesh të përqendruara sidomos...". A mund ta shpjegosh termin escalation? A ka ndonjë fjalë përkatëse në gjuhën shqipe?


.....

.....

.....

**2.** Në fillim u mendua se autorët e grabitjeve ishin anëtarë të një bejbi geng, një shprehje tjetër në anglisht që shkruhet

dhe që do të thotë..... . Kronikat e lajmeve shpesh raportojnë episode kriminale (dhunë, përleshje, grabitje) të kryera nga bejbi geng-ët. Si e shpjegojnë psikologët këtë fenomen? Bëni një kërkim dhe diskutoni atë në klasë.



#### Përcaktimi i ndjenjave

Kur hyn në burg, Danieli është i mbingarkuar nga "ndjenja të përziera: angështi e nënshtrim, por edhe kryelartësi e rebelim. Në mendjen e Danielit po zhvillohej një luftë". Le t'i shohim një nga një ndjenjat që janë protagoniste të kësaj "luftë".

**1. ANGËSHTIA:** është një dhimbje e thellë, një gjendje shpirtërore që mund të na bëjë të zhytëmi në trishtim. Nëse do të duhej të bëje një renditje nga më pak i forti deri tek më i forti, a do ta vije ankthin apo angështinë të parën?

**2. NËNSHTRIMI:** do të thotë të dorëzohesh, të heqësh dorë nga një projekt, të lësh. Cila është e kundërta e "nënshtrimit"?

**3. KRENARIA/KRYELARTËSIA:** mbrojtje e dinjitetit të dikujt, vetëbesim, ndonjëherë vetëvlërsim i tepërt. A është Danieli një tip krenar? Po ti? A mendon se krenaria është një qëndrim pozitiv apo negativ? Pse?

#### Reflektim personal:

FIGURA EMOCIONESH






Lidh çdo figurë emocioni me njëren nga gjendjet shpirtërore të përshkruara më sipër.

#### PUNË KRIJUESE

##### NJË PËRQAFIM QË NUK MBARON KURRË

Kjo është ajo që po kërkon Danieli. Një përqaftim të madh, që ta mbështjellë plotësisht, me gjithë botën e tij; një përqaftim që zgjat përgjithmonë. Përqaftimi është një imazh (një metaforë) që përfaqëson dashurinë: ky djalë i vuajtur ka nevojë për dashuri, ai e kërkon atë në marrëdhëniet me Marikën dhe Dulinën, e kërkon në kontaktin fizik me të ëmën. Përpiqu të mendosh për një imazh që paraqet dashurinë ashtu siç e kupton ti. Mund të jenë dy duar që mbajnë njëra-tjetrën, por mund të jetë edhe diçka që nuk përfshin kontakt fizik, si fjalët... Vizato atë që ke menduar dhe vëri një titull punës tënde. [MR1] Vetem fjala në anglisht argëtimit? Ballafaqohuni dhe hapni një debat.

## NDJENJA:

### PAQETËSIA

Kur Maksimi arrestohet, Danieli fillon të jetojë me një shqetësim që nuk e lë rehat, me një paqetësi që e bën të ndihet në siklet kudo: ai nuk di më se ku të shkojë.

Përpiqu të mendosh për kuptimin e fjalës “paqetësi”, e cila përfshin termin qetësi. i qetë:

kurse “i paqetë” :

Pse nuk ka paqe Danieli? Mendime të ndryshme e mundojnë atë: cilat janë ato? Dhe çfarë është gjëja që e angjeshon më shumë atë?

Ndihemi të paqetë kur nuk e dimë mirë se çfarë na pret ose se si do të shkojnë gjërat. Paqetësia është e lidhur me pasigurinë, është një pritje plot me ankth. “Më mirë të vinin e të më merrnin tani”, thotë Danieli. Çfarë do të thotë kjo sipas teje?

## Të rriturit: AUTORITETET

**KARABINIERËT** që arrestojnë Danielin si sillen me të? Pse mendon se nuk ia vënë prangat?

Po Danieli? A i respekton? A ka frikë prej tyre? Apo rebelohet?

### MBAJ MEND.

Karabinierët, ashtu si Policia, janë pjesë e të ashtuquajturave “forca të zbatimit të ligjit”, të cilat janë përgjegjëse për garantimin e sigurisë së qytetarëve dhe ruajtjen e rendit publik, domethënë bashkëjetesën paqësore midis njerëzve. Prandaj, ata janë përgjegjës për zbatimin e ligjeve.

## HUMBJA E LIRISË

Liria është një nga të drejtat themelore të njeriut dhe Kushtetuta e mbron atë. Por kur një qytetar e shkel ligjin në mënyrë të rëndë, Shteti ia heq përkohësisht lirinë për ta detyruar atë që të ndjekë një rrugëtim të veçantë, të ndarë nga pjesa tjetër e shoqërisë. Ky është kuptimi i burgjeve dhe i institucioneve për të mitur (sidomos i burgjeve për djem dhe vajza që janë të paktën 14 vjeç), si Bekaria, për të cilin flitet në libër: do të duhet që t'i riedukonin njerëzit që nuk kanë pasur mundësi që ta marrin atë, t'i ndihmojnë të qëndrojnë me të tjerët në mënyrë konstruktive dhe jo shkatërruese. Danieli nuk e kishte menduar kurrë në atë mënyrë. Për të, burgu është një lloj kalimi i detyrueshëm për t'u bërë një kriminel i vërtetë dhe për t'u ngjarë modeleve të tij. Por kur vjen momenti e kap frika.

**1.** “Pasi ta kem kaluar atë derë, përgjithmonë do ta kem damkën: kriminel”. Çfarë do të thotë Danieli me këtë fjali? A mendon se ka të drejtë? Argumentoje përgjigjen tënde.

**2.** Çfarë janë “hierarkitë e brendshme të burgut”? A është Danieli në disavantazh apo në avantazh? Pse? Pak nga pak del në pah ndjesia se burgu është një botë më vete, me rregulla që janë “të kundërta” me botën e jashtme: në ç'kuptim, sipas teje?

**3.** Cili është imazhi, zhurma apo aroma e përshkruar që të ka bërë më shumë përshtypje në lidhje me “shtëpinë” e re të Danielit?